



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT RREGULLATIV
Përcaktimi i Tarifave për Ndrohtoren e Qytetit TERMOKOS SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2021-2022

Prishtinë, tetor 2021



1. Hyrje – Struktura Tarifore

Struktura tarifore për energjinë termike është përcaktuar në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike të nxjerrë nga ZRRE (Kapitulli IV: Tarifat e energjisë termike – nenet 15 dhe 16). Struktura e tarifave të energjisë termike përmban 2 lloje të tarifave: Tarifat për 'konsumatorët me matje' dhe tarifat për 'konsumatorët pa matje', varësisht nga Infrastruktura e matësve (njehsorëve) të energjisë termike.

1.1 Tarifat për 'konsumatorët me matje'

Tarifat për 'konsumatorët me matje' janë të bazuara në konsumin e matur dhe të regjistruar të energjisë termike. 'Tarifat me matje' përbëhen nga:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €cent/kWh];

1.2 Tarifat për 'konsumatorët pa-matje'

Tarifat për 'konsumatorët pa-matje' bazohen në sipërfaqen e hapësirës së ngrohur të konsumatorëve. Duke marrë parasysh se vlerat e parallogaritura për kapacitetin dhe konsumin specifik të energjisë termike për metër katrorë janë të ndryshme për Konsumatorët Shtëpiak dhe ata Komerical e Institucional, për këtë, me qëllim që tarifat të reflektojnë strukturën specifike të konsumit për secilën kategori, 'tarifat pa-matje' ndahen në dy nën-grupe:

- Tarifat për konsumatorët shtëpiak; dhe
- Tarifat për konsumatorët komercial e Institucional.

Më tutje, 'tarifat pa-matje' kategorizohen në dy komponentë:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në një vlerë të përafërt për kapacitet të ngrohjes për metër katror të hapësirës për ngrohje [€/m² për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: pagesa mujore e energjisë bazuar në një vlerë të përafërt për konsum të ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse [€/m² për muaj].

2. Alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit

Duke ju referuar Shtojcës 6: "Detajet për Llogaritjen e Tarifave" të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe për të reflektuar strukturën tarifore, për llogaritjen e tarifave të energjisë termike duhet të përcaktohet alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit.

2.1 Alokimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara (HML)

Alokimi i të Hyrave të lejuara bëhet konform strukturës tarifore, të përshkruar në pikën '1' më lartë, me pikë fillestare të Hyrat e Lejuara, siç janë përcaktuar në Raportin për të Hyrat e Lejuara për NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2021/22, në vlerë prej **7,185,202 €**. Kriter themelorë për alokimin është konsumi i përlogaritur i energjisë termike për secilën kategori/komponentë tarifore. Bazuar në këtë kriter dhe kategoritë / komponentët e strukturës tarifore, janë përcaktuar koeficientët e alokimit dhe alokimi respektiv i të Hyrave të Lejuara; detajet në vijim:



- Alokimi i HML për tarifat e 'Konsumatorëve me-matje' dhe 'pa-matje' - Alokimi përkatës i të Hyrave të Lejuara bëhet përmes koeficientëve respektiv të alokimit, si në vijim:
 - a) Për tarifat 'me-matje': $k_{a(matje)} = 0.30$; $HML_{(matje)} = 2,139,846 \text{ €}$
 - b) Për tarifat 'pa-matje': $k_{a(pamatje)} = 0.70$; $HML_{(pamatje)} = 5,045,356 \text{ €}$
- Alokimi i HML në komponentën Fikse dhe Variabile:
 - a) Për tarifat 'me-matje':
 - i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: $HML_{F(matje)} = 253,251 \text{ €}$; dhe
 - ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: $HML_{V(matje)} = 1,886,595 \text{ €}$
 - b) Për tarifat 'pa-matje':
 - i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: $HML_{F(pamatje)} = 731,577 \text{ €}$;
e cila më tutje ndahet në:
 - kategorinë shtëpiak: $HML_{F(pamatje-Sh)} = 573,805 \text{ €}$ dhe
 - kategorinë komercial e institucional: $HML_{F(pamatje-K\&I)} = 157,772 \text{ €}$
 - ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: $HML_{V(pa-matje)} = 4,313,779 \text{ €}$
e cila më tutje ndahet në:
 - kategorinë shtëpiak: $HML_{V(pamatje-Sh)} = 3,383,473 \text{ €}$ dhe
 - kategorinë komercial e institucional: $HML_{V(pamatje-K\&I)} = 930,306 \text{ €}$

2.2 Përcaktuesit e Faturimit

Njëjtë si alokimi i të Hyrave të Lejuara, edhe përcaktuesit e faturimit reflektojnë dhe janë në pajtim me strukturën tarifore; detajet në vijim:

- a) Për tarifat 'me-matje':
 - i) Kapaciteti termik: $N_{matje} = 54,204 \text{ kW}$; dhe
 - ii) Konsumi sezonal: $Q_{matje} = 52,049 \text{ MWh}$.
- b) Për tarifat 'pa-matje':
 - i) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve shtëpiak: $S_{(pamatje-Sh)} = 873,061 \text{ m}^2$; dhe
 - ii) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve komercial e Institucional: $S_{(pamatje-K\&I)} = 191,430 \text{ m}^2$



3. Nivelet e Tarifave të Energjisë Termike

Në pajtim me strukturën tarifore, si dhe bazuar në alokimin e të Hyrave të Lejuara dhe përcaktuesit e faturimit, llogariten nivelet e tarifave për secilën kategori / komponentë tarifore, siç paraqiten në tabelën vijuese:

Tabela 1: Struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2021/22:

Llogaritja e Tarifave të Energjisë Termike -sezonit 2021-2022						
A. Tarifat e Energjisë Termike me Matje						
Simboli/Pos.	Përshkrimi	Formula	Njësia	Vlera		
$MAR_{(matje)}$	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifën me matje	$MAR_{(matje)} = k_{d(matje)} * MAR$	Euro	2,139,846		
$MAR_{f(matje)}$	Pjesa fikse e MAR për tarifën me matje	$MAR_{f(matje)} = k_{af(1)} * MAR_{(matje)}$	Euro	253,251		
$MAR_{v(matje)}$	Pjesa Variabile e MAR për tarifën me matje	$MAR_{v(matje)} = k_{av(1)} * MAR_{(matje)}$	Euro	1,886,595		
N_{matje}	Kapaciteti Termik	$N_{matje} = (S_{matje} * CDsp) / 1000$	kW	54,204		
Q_{matje}	Konsumi / Furnizimi i planifikuar sezonal	$Q_{matje} = HD_{matje} * t_{dte}$	MWh	52,049		
T_{TMC}	Tarifa Sezonalë për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{TMC} = MAR_{f(matje)} / N_{matje}$	€ / kW për sezonë	4.67		
T_{MVC}	Tarifa mujore për kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{MVC} = T_{TMC} / 6$	€ / kW për muaj	0.78		
T_{MVD}	Tarifa për Sasinë e Furnizuar të Energjisë Termike (Komp. Variab.)	$T_{MVD} = MAR_{v(matje)} / Q_{matje}$	€ / MWh	36.25		
B. Tarifat e Energjisë Termike Pa Matje						
Simboli/Pos.	Përshkrimi	Formula	Njësia	Vlera		
				Gr. Kons. Shtëpiak	Gr. Kons. Kom. e Inst.	Total / Mesatare
$MAR_{(pa matje)}$	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifën pa matje	$MAR_{(pa matje)} = k_{d(pa matje)} * MAR$	Euro	3,957,279	1,088,077	5,045,356
$MAR_{f(pa matje)}$	Pjesa fikse e MAR për tarifën pa matje	$MAR_{f(pa matje)} = k_{af(1)} * MAR_{(pa matje)}$	Euro	573,805	157,771	731,577
$MAR_{v(pa matje)}$	Pjesa variabile e MAR për tarifën pa matje	$MAR_{v(pa matje)} = k_{av(1)} * MAR_{(pa matje)}$	Euro	3,383,474	930,306	4,313,779
$S_{(pa matje)}$	Sipërfaqja ngrohëse e Kons. pa matje		m ²	873,061	191,430	1,064,491
T_{TMC}	Tarifa Sezonalë për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{TMC} = MAR_{f(pa matje)} / S_{(pa matje)}$	€ / m ² për sezonë	0.66	0.82	0.69
T_{TMD}	Tarifa Sezonalë për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{TMD} = MAR_{v(pa matje)} / S_{(pa matje)}$	€ / m ² për sezonë	3.88	4.86	4.05
T_{MVC}	Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{MVC} = T_{TMC} / 6$	€ / m ² për muaj	0.11	0.14	0.11
T_{MVD}	Tarifa Mujore për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{MVD} = T_{TMD} / 6$	€ / m ² për muaj	0.65	0.81	0.68
T_{total}	Totali i tarifës mujore pa matje	$T_{total} = T_{MVC} + T_{MVD}$	€ / m ² për muaj	0.76	0.95	0.79